



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. .... Prot.

Vlorë, më 01.09.2016

**Vendim**  
**Nr. 31, datë 01.09.2016**

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE DHE RIALOKIMEVE**  
**NË REGJISTRIN E PROKURIMEVE**  
**TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Mbështetur në nenin **37**, pika **1**, nenin **38**, pika **1** të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 29, pika 5 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", VKM Nr 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Senati Akademik i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, në mbledhjen e datës 01.09.2016

**VENDOSI:**

- 1.** Të miratojë ndryshimet dhe rialokimet në regjistrin e prokurimeve për zërat e mëposhtëm në buxhet:
  - a) Investim "Rikonstrukcion zyresh, Fakulteti Ekonomik",
  - b) Investim "Rikonstrukcion dhe sistemim i mjediseve të Bibliotekës së Universitetit",
  - c) Blerje inventar ekonomik: procedura të kryhet e ndarë në lote.
- 2.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Drejtoria e financave, Kancelari i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Zyra e shërbimeve.
- 3.** Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
- 4.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Roland ZISI**

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.